



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0259

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Muhamet Muçiqi”, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA E PODUJEVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ngritja e infrastrukturës së turizimit” me numër të prokurimit 615-24-10786-5-2-1, me 04/06/2025, mori:

Vendim

- 1. Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Muhamet Muçiqi” me nr. 2025/0259, e datës 10/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ngritja e infrastrukturës së turizimit” me numër të prokurimit 615-24-10786-5-2-1.
- 2. Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të "KOMUNA E PODUJEVËS", lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ngritja e infrastrukturës së turizimit” me numër të prokurimit 615-24-10786-5-2-1
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Muhamet Muçiqi”
5. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 14.10.2024, “KOMUNA E PODUJEVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ngritja e infrastrukturës së turizimit” me nr. të prokurimit: 615-24-10786-5-2-1. Ndërsa me datën 24.03.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €.

Me 28.03.2025, OE “Muhamet Muçiqi” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 01.04.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10/04/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Muhamet Muçiqi” me nr. 2025/0259 për lidhur me aktivitetin “Ngritja e infrastrukturës së turizimit” me nr. të prokurimit: 615-24-10786-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/1245 i dt:10.02.2025.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Muhamet Muçiqi” janë parashtruar si në vijim:

AK - KOMUNA E PODUJEVËS, një datë 24.03.2025, përmes platformës elektronike e-prokurim merr vendim - 058 Njoftimi mbi vendimin e AK, që do thotë se me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, dhe rreg. Nr. 001/20222 për PP të cilat do i argumentoj dhe dëshmojmë me prova dhe fakte konkret si ne vazhdim të kësaj Ankese .

Andaj duke marr për bazë dispozitat ligjore të nenin 4 të LPP-se ne si OE me pale me interes sipas nenit 4 par. 1,26 të LPP-se edhe pre kundër faktit se ne kemi kemi arritur të plotësojmë të gjitha kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në dosje tenderit dhe njoftimin për kontratë, mirëpo AK - Komisioni i vlerësimit - ZPP duke shkelur dispozitat ligjore të LPP, duke na eliminuar padrejtësisht, duke ne diskriminuar në detyrohemi të parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim pran AK duke pasqyruar dhe një here faktet dhe argumentet lidhur me Stafin teknik dhe profesional dhe ISO Standardet Valide të cilat i kemi dorëzuar në platformën elektronike e-prokurim për këtë AK me rastin e aplikimit ku argumentohet dhe konstatohet se të gjitha dokumentacionin e kërkuar për këtë AP janë në pajtim të plote me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë - duke plotësuar në tërësi kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin kryesor të dhënies së kontratës - çmimi me

i ulet i përgjegjshëm. AK me rastin e eliminimit të kompanisë tonë për aktivitetin të prokurimit përmes njoftimit 058 vendimit mbi eliminimin e aktivitetit të prokurimit duke na shpallur si OE TE ELEMINUAR. Ne tani po ngjasi disa pretendimet ankimore dhe disa arsyetime KONSTATIME në këtë AP - Procedure të Prokurimit, si më poshtë:

Pretendimi: 1: Autoriteti kontraktues - komisioni i vlerësimit - ZPP në komunën e Podujevës, me rastin e eliminimit përmes B42

- letrës standarde të eliminimit të datës; 24.03.2025, në shkelje të nenit 59 dhe 60 të LPP-se dhe nenit 43 të Rreg. Nr. 001/2022 për PP, (Krejt kjo është bërë duke na diskriminuar duke vlerësuar plotë 42 ditë nga data e vendimit të OSHP - PSH nr. 2024/1253 të datës 10.02.2025) duke jap arsyetime si ne vijim:

AK me rastin e RIVLERESIMIT duke e vonuar plotë 42 ditë duke shkelur nenin 40.3 të Rregullores nr. 001/2022 për PP si dhe duke ndryshuar komplet arsyetimet mbi eliminimin të kompanisë tone konkretisht GOE duke mos dhënë asnjë provë me fakte dhe argumente por vetëm duke përshkruar dhe duke u thirrur në nenin 69 të LPP-se.

Në ja rikujtojmë AK - ZPP dhe Komisionit të vlerësimit se Vlerësimi I tenderëve duhet të bëhet në pajtim të plotë me nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-se dhe jo të jep përshkrim dhe të thirret në dispozita ligjore që nuk qëndron dhe nuk bëhet vlerësimi për faktin se nëni 69 përcakton kriteret e teknike dhe profesionale që ne jemi pajtuar dhe kemi arritur të plotësojmë të gjithë në plotni dhe në pajtim me nenin 59 dhe 60 të LPP-se ne jemi GOE të përgjegjshëm, mirëpo AK me vetë dhe qellim të caktuar edhe përkundër vendimit të OSHP - PSH nr. 2024/1253 në eliminon padrejtësisht dhe duke na diskriminuar duke ndryshuar arsyetimin nga komisioni I parë I vlerësimit vetëm e vetëm për të rekomanduar OE të preferuar dhe të cilët janë të papërgjishëm ku ne vijim të kësaj KpR do të argumentojmë dhe faktojmë papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë nga AK - ZPP dhe komisioni i RI- vlerësimit.

Andaj ne vijim po theksojmë arsyetimin e eliminimit në letrën standarde të eliminimit të datës 24.03.2025 që keni pranuar përmes platformës elektronike e-prokurim si ne vijim:

Duke ofruar dëshmi me fakte dhe prova konkretë dhe fakte për secilën Punëtorë - Staf Profesional dhe teknik duke prezantuar kontratë mbi marrëveshje me titull dhe numër të prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit, duke plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuar tek kriteret e përzgjedhjes të Dosjes së tenderit.

AK - ZPP KA PERSHKRUAR PAISJE DHE MEKANIZIMIN KINSE NE NUK I POSEDOJM PA SPECIFIKUAR SE CILA PAISJE E DOREZUAR NGA ANA JONE NUK ESHTË SIPAS ANEKSIT TE ST POR KA DHE NEJ PERSHKRIM PA PREZANTUAR FARE DESHIMI DHE FAKTE, KREJT KJO ME NJE QELLIM TE CAKTUAR PER TE ANULUAR KETE AP DHE MOS TE NE SHPERBLEJ ME KONTRAT DUKE NA DISKRIMINAU

Pra kjo dëshmon se AK - ZPP me rastin e eliminimit të kompanisë tone për këtë aktivitet të prokurimit dhe arsyetimin tek letra standarde e eliminimi, ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-se, konkretisht nenin 1, 2, 7, 24, 56 59, dhe 60 të LPP-se, andaj kërkojmë fillimisht nga ZPP në KpR të analizoj shfletoj të gjitha dokumentet të cilat i kemi dorëzuar me rastin e tenderimit për këtë AP pasi që kemi ofruar dëshmi konkret për të gjitha stafin tonë të prezantuar në listën e nënshkruar dhe vulosur, duke prezantuar diplomat CV-it të nënshkruar nga vetë inxhinierët ashtu

sikurse është kërkuar “Kontrata te rregullat ose para kontrata për angazhim për këtë projekt” si dhe Certifikata e noterizuar nga vete punëtorët teknik për këtë aktivitet të prokurimit sipas të dosjes së tenderit dhe arsyetimi i AK në Letrën standarde të eliminimit nuk qëndron dhe çdo prove dhe dëshmi ekziston në dokumentet e dorëzuar nga ana jone me rastin e tenderit për këtë AP.

Gjithashtu në kemi dorëzuar tender të përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit duke plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe NJK edhe përkundër se AK ka verifikuar dhe hulumtuar në ATK dhe rrugë tjerat paligjshme, neja rikujtojmë AK-ZPP Komisionit të RIVLERESIMIT se nga Komisioni i parë për këto pike jemi shpall të përgjegjshëm që dëshmon dhe argumenton se AK qëllimisht na diskriminon dhe na eliminon padrejtësisht dhe në shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së konkretisht nenit 7, 59 dhe 60 të LPP-së, sepse në kemi prezantuar për stafin tonë para kontratës për këtë AP duke e plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, andaj me drejtë kërkojmë nga AK dhe Komisioni i RIVLERESIMIT të na trajtojë barabartë duke mos na diskriminuar dhe vlerësimin të baje në pajtim të plotë me kërkesat përcaktuar vete tek kriteret e përzgjedhjes dhe mos të na eliminojë në shkelje të nenit 56 par. 3 të LPP-së

Provë; Dokumentet e dorëzuar me rastin e tenderimit në ofertën tonë e-prokurimi për këtë AP.

Pretendimi: 2: AK - Komisioni i Ri-vlerësimit - ZPP me rastin e anulimit të aktiviteti të prokurimit ka shkelur nenin 59 të LPP-së për faktin se se GOE: Muhamet Muçiqi B.I.; Ledi SHPK; Ibrahim Kurrumeli B.I. - Llapashticë e Poshtme, ka arritur të plotësojë kërkesën e dosjes së tenderit konkretisht llojin e paisjeve dhe mekanizmit tek Kërkesa3/Dëshmia3 e FDT-së, pasi që bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit tek kërkesat teknik dhe profesionale neni 9.1& 9.2 të FDT-së sikurse në vijim:

Operatori ekonomik duhet të jetë certifikuar sipas standardëve ISO 14001-2015 -ISO 39001-2012 -ISO 45001-2018 Certifikatat një validitet

Duke marrë për bazë kriteret e përzgjedhjes në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë të Dosjes së tenderit në po elaborojmë me faktet dhe dëshmitë që kemi dorëzuar në këtë aktivitet të prokurimit me rastin e tenderimit përmes platformës elektronike e-prokurim si me poshtë dhe të cilat shumë lehtë konstatohet edhe në platformën elektronike e-prokurim. Andaj po prezantojmë fakte dhe argumente se në kemi ofruar të gjithë dëshmitë lidhur me ISO STANDARDET sipas kërkesës si me lart duke ofruar nga GOE: Muhamet Muçiqi B.I. ; Ledi SHPK; Ibrahim Kurrumeli B.I. - Llapashticë e Poshtme, ISO STANDARDIN 14001:2025 me vlefshmëri deri në datën: 20.08.2026 që shumë qarte shkruan se kur jemi certifikuar dhe sa vlen ky certifikim për periudhë 3 vjeçare si me poshtë:

Kjo dëshmon shumë qarte se AK - ZPP Komisioni i RIVLEREIMIT na eliminon krejt padrejtësisht duke na diskriminuar sepse qarte shkruan kur jemi certifikuar dhe sa vlen ose/apo sa është periudhën që vlen ky ISO standard - Certifikim i cili e plotëson dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, po ashtu ka mundur të veprojë sipas nenit 72 të LPP-së të shkruajë direkt kompanisë e cila e ka lëshuar këtë certifikatë.

Prove: Dokumentet e dorëzuar një rastin e tenderimit në ofertën tonë e-prokurimi për këtë AP ISO Standardi 14001:2025 një vlefshmërinë deri në datën 20.08.2026

Po ashtu prove është edhe Arsyetimi i eliminimit me date: 04.12.2025 që dëshmon se AK - Komisioni i RIVLERESIMIT i ka ndryshuar të gjitha arsyet e eliminimit si dhe ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-se, duke mos u thirrë në fakte dhe argumente por jap një përshkrim i cili është në shkelje të nenit 56 par. 3 të

LPP-se, sepse nuk bazohet në kritere të përzgjedhjes të përcaktuar në NJK dhe DT, por mundohet të arsyetoj pa fakte konkret vetëm e vetëm të na eliminoj dhe të na diskriminoj dhe favorizoj OE të caktuar.

PRETENDIMI 3: AK - Komisioni i Ri-vlerësimi - ZPP me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit ka shkelur nenin 59 të LPP-se për taktin se se GOE: Muhamet Muçiqi B.I.; Ledi SHPK; Ibrahim Kurrumeli B.I. - Llapashticë e Poshtme, ka arritur të plotësoj kërkesën e dosjes së tenderit konkretisht llojin e paisjeve dhe mekanizmit tek Kërkesa3/Deshmia3 e FDT-se, pasi që bazuar në kërkesën e dosjes tenderit tek kërkesat teknik dhe profesione neni 9.1 & 9.2 të FDT-se sikurse në vijim: Prandaj. AK - ZPP - Komisioni i RIVLERESIMIT kanë shpallur rekomanduar për dhënie të kontratës GOE: Elite Premium Bau Shpk ; EING COM Shpk-Podujeve në shkelje të nenit 59 dhe 60 të LPP-se, për faktin se ky GOE nuk ka dëshmuar “a testi për vëllimin të cisternës” gjë që bënë këtë OE të papërgjeshëm duke na diskriminuar dhe duke e favorizuar këtë GOE pasi që në kemi prezantuar Cisternën për pastrimin e rrugëve me A test vëllim, dhe ky veprim i AK - ZPP është në shkelje të nenit 7, 59 dhe 60 të LPP-se.

Prove: Atesit për cisternën tone, ndërsa GOE nuk e ka dëshmuar dhe nuk ka sjellë asnjë dëshmi për “A teste vëllim të Cisternës” gjë që e bënë këtë GOE të pa përgjegjshëm dhe i cili duhet të eliminohet dhe jo të rekomandohet për dhënie të kontratës.

Gjithashtu, në përveç që kemi tenderuar në pajtim të plote me të gjitha kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në dosje tenderit, po ashtu duke plotësuar Aneksin 7 me dokumentet relevante dhe dëshmi konkret, NE kemi tenderuar edhe me çmimin me të ulët të përgjegjshëm duke vendosur çmimin me të ulët se sa GOE të rekomanduar për kontratë për rreth: 17,774.70 Euro. Me këtë veprim AK - ZPP ka shkelur parimin kryer të prokurimit “VLEREN PER PARA” me rastin e eliminimit të tone dhe rekomandimin e GOE për dhënie të kontrate, duke dëmtuar Buxhetin e Komunës dhe të Republikës së Kosovës në vlerë: 17, 774.70 Euro , pasi që ka rekomanduar një GOE të papërgjegjshëm si dhe në ka eliminuar NE si GOE me çmimin të ulët të përgjegjshëm

Provë: Përshkrimi i Çmimeve të dorëzuar nga ana jone - Procesverbali i hapjes.

Në mbështetje me shprehje se AK - ZPP do të reflektojnë dhe të shterohen të gjitha mundësit ligjore të cilat janë të parapara me dispozita ligjore të LPP-se, dhe të sigurohen dhe të konstatojnë se NE si GOE jemi të përgjegjshëm dhe plotësojmë kushtet dhe kriteret e dhënies sipas dosjeje së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do (ë veprojë në mënyrë (transparente) ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontratë.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe nenin 1 te LPP.-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosovës.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Muhamet Muçiqi” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim Neni 1 të LPP-së, Neni 2 të LPP-së, Neni 6 të LPP-së, Neni 7 të LPP-së, Neni 24 te LPP-së, Neni 52 të LPP—së, Neni 56 të LPP—së, Neni 59 të LPP-së, Neni 60 par. 1.1 te LPP-së, Neni 40.6; 40.7 dhe 40.8 të Rreg. Nr. 001/2022 për PP, Nenin 43 te Rreg. Nr. 001/2022 për PP, Nenin 45 te Rreg. Nr. 001/2022 për PP.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Operatori Ekonomik “Muhamet Muciqi B.I - Podujeve, me date 28.03.2025, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit te Autoritetit Kontraktues - Komuna Podujevë, lidhur ne procedurën e prokurimit: "Ngritja e infrastrukturës se turizmit”, me numër të Prokurimit: 615-24-10786-5-2-1.

Parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim, ka paraqitur pretendimet ankimore ndaj njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues te datës 28.03.2028, dhe kundërshtohet eliminimit i ankuesit me pretendimet se AK - Komuna Podujevë ka shkelur nenet 1, 2, 6, 7, 24, 52, 56 dhe 60 te LPP - se, dhe ne deklarate te kërkesës për ri shqyrtim thekson se është i përgjegjshëm, i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit, duhet te shpallet i përgjegjshëm dhe te rekomandohet për dhënien e kontratës meqë për këtë aktivitet te prokurimit ka patuar ankese ne OSHP dhe lënda është kthyer ne ri vlerësim.

Përgjigjet e ZPP-se ndaj pretendimeve ankimore:

Zyrtari përgjegjësi i prokurimit te Autoritetit Kontraktues - Komuna Podujevë, pas shqyrtimit dhe analizimit te pretendimeve ankimore te Operatorit Ekonomik ankues, konstaton se AK Komuna Podujevë , se pari ka zbatuar vendimin e OSHP-se, lenden e ka kthyer ne ri vlerësim dhe ka autorizuar komision ri vlerësues te ofertave ku i njëjti komision sipas dispozitave te nenit 59, te LPP-se ka vlerësuar, ka ekzaminuar dhe i ka krahasuar ofertat e këtij aktiviteti te prokurimit bazuar ne kërkesa te dosjes se tenderit dhe bazuar ne rregullat ligjore.

Nga komisioni ri vlerësues është konstatuar se për stafin e prezantuar keni prezantua kontrata – i marrëveshje ku potencohet se keni krijuar detyrime kontraktuale me stafin kyç te përmendur ne letër standarde dhe ne arsyetim te eliminimit.

Me rregulla tatimore dhe i ne njoftime te ATK-se, stafi i kontraktuar duhet te deklarohet ne ATK. Komisioni Ri vlerësues, pas vlerësimit dhe ekzaminimit te ofertave përkatësisht verifikimit ne ATK, ka rezultuar se stafi i përmendur nuk janë te deklaruar sipas marrëveshjeve kontraktuale dhe se te njëjtë janë te deklaruar ne kompani tjera.

Komisioni ri vlerësues është bazuar ne ofertën tuaj dhe ne kërkesa te dosjes se tenderit dhe ne njoftimin e datës 13.02.2024, te publikuar ne faqen e ATK-se si me poshtë:

Njoftim:

Administrata Tatimore e Kosovës Ju njofton se sot me datë 13 shkurt 2024 publikoj Versionin e ri të Sistemit Elektronik EDI, përmes të cilit do të kërkohej që çdo punëdhënësi të informojë ATK-në për lidhjen e një kontrate të punës një ditë para fillimit të punës së punëtorit. Shërbimi i ri elektronik për lajmërimin e punëtorit është funksionalizuar në Sistemin Elektronik EDI duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, gjegjësisht nën 43, paragrafin 5.

Përmes këtij shërbimi, çdo punëdhënësi është i obliguar për ofrimin e informatave për të punësuarin e ri, sipas formës së përcaktuar nga ATK-ja, e cila gjendet në tlenjja “Shërbimet - Regjistro punëtorin e ri”.

Më konkretisht përmes shërbimit “Formë për regjistrimin e punëtorit”, përveç informatave që merren përmes Agjencisë për Regjistrimin Civil (ARC) dhe informatave përmes listës së pagesës mujore, punëdhënësi do të jetë i obliguar që të ofroj edhe informatat shpesh, si:

- Data e fillimit të punës; •Data e ndërprerjes së punësimit; •Orari i punës, i plotë apo i pjesshëm;
- Niveli i shkollimit të punëtorit; •Profesioni i punëtorit; •Pozita e punës së punëtorit, etj.

Për plotësimin e saktë të informatave për të punësuarin, ATK-ja ka përgatitur “Udhëzuesin për plotësimin e formularit për regjistrimin e punëtorëve”, të cilin do ta gjeni në dritaren përkatëse në të cilën bëhet plotësimi i formularit, andaj ju sugjerojmë që paraprakisht ta shfletoni udhëzuesin. ATK mban premtimin për kujdesin e vazhdueshëm ndaj tatimpaguesve!

Po ashtu edhe ISO Certifikata 14001:2015, e dorëzuar në oferte sipas verifikimit rezulton të jetë e skaduar me datën 20.08.2024, prandaj oferta e juaj është eliminuar si e pa përgjegjshme nga komisioni i vlerësues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 11.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0259/2025, ndërsa me datë 25.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0259/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e OE “Muhamet Muçiqi” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0259 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin e 1: Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me njoftimin mbi vendimin e AK-së, me të cilin GOE ankues eliminohet nga aktiviteti i prokurimit. Pika ankimore ka të bëjë me afatin e vlerësimit të ofertave dhe arsyet e eliminimit të GOE-së, me pretendimin se janë ndryshuar arsyetimet e eliminimit nga vlerësimi i komisionit të parë të vlerësimit.

Pretendimet përfshijnë arsyetimin e eliminimit për: -Listën e stafit profesional dhe arsyetimin e eliminimit në këtë pikë-Validiteti i certifikatës ISO 14001:2005-Lista e pajisjeve të dorëzuara nuk ka qenë sipas kërkesave të dosjes së tenderit

OE ankues me ofertë ka dorëzuar listën e stafit profesional me dëshmitë përkatëse, sipas kërkesës së FDT-së.

AK ka kontestuar stafin Faruk Kryeziu, Lulëzim Zogaj dhe Mërgim Berisha, si dhe gjithashtu edhe stafin mbështetës. Arsyeja e eliminimit ka qenë se stafi i propozuar është i angazhuar edhe në kompani tjetër, në rol primar ose sekondar, dhe për rrjedhojë nuk është në përputhje me kërkesat e FDT-së. Eksperti shqyrtues sqaron se me FDT neni 9.1 & 9.2 për këtë pikë si dëshmi për stafin është kërkuar -Lista e stafit profesional të dorëzohet në origjinal e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin, Profesionin, Eksperiencën (vitet) ,(CV e nënshkruar nga vet inxhinieri), dhe pozicionin në kompani e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Dëshmi kopja e diplomës e noterizuar nga origjinali. Kontratë të rregullt ose para kontratë në emër të këtij projekti. Certifikatat të noterizuara nga origjinali nga vetë Inxhinierët. Për stafin Teknik kontratat e rregullta ose parakontratat për angazhim në këtë projekt. certifikatat të noterizuara nga vetë punëtorët Teknik.

OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar për F.K, menaxher i projektit Marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt

Njëjtë ka dorëzuar marrëveshje bashkëpunimi edhe për zyrtaret tjerë: L.Z, E.M, E.R, M.B, Q.M, dhe I.P.

Eksperti shqyrtues vlerëson se sipas kërkesave të FDT-së AK ka kërkuar që përveç kontratës së rregullt OE mund të dorëzojnë edhe “para kontratë” në emër të këtij projekti ndërsa arsyetimi në vendimin e kërkesës për rishqyrtim cek se OE nuk i ka deklaruar stafin në ATK sipas njoftimit të ATK-së.Marrëveshjet e bashkëpunimit për projekt të caktuar kanë efekt juridik vetëm në rastin kur OE shpërblehet me kontrate për atë projekt kur edhe duhet të zbatohet kërkesa sipas njoftimit të ATK-së.Eksperti shqyrtues vlerëson se vendimi në kërkesën për rishqyrtim nuk është në përputhje me kërkesat e FDT-së apo njoftimin e ATK-së, sepse OE ankues në këtë rast ka marrëveshje bashkëpunimi për projektin dhe është i lidhur me shpërblimin apo jo të kontratës.OE i rekomanduar për kontratë është i obliguar që stafin e propozuar në ofertën e tij ta ketë në dispozicion për realizimin e kontratës me rastin e nënshkrimit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK, gjatë vlerësimit të ofertave në këtë pikë, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së; rrjedhimisht, pretendimi ankimor vlerësohet si i qëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit që ka të bëjë me standardin ISO 14001:2015, AK në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim e ka refuzuar atë me arsyetimin se e njëjta është verifikuar të organi certifikues sipas numrit të certifikatës dhe ka rezultuar pa validitet.

Eksperti shqyrtues sqaron se certifikata është lëshuar nga trupi certifikues mlkgrup.com. Me qëllim të verifikimit të vlefshmërisë së certifikatës, nga verifikimi i kryer rezultoi se certifikata është valide. Prandaj, bazuar në dëshmitë e marra nga faqja zyrtare e trupit certifikues, eksperti shqyrtues vlerëson se AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 7 gjatë trajtimit të ofertës së OE

ankues në këtë pikë dhe se pretendimi që ka të bëjë me validitetin e certifikatës është i qëndrueshëm.

Sa i përket pjesës së pretendimit në lidhje me listën e pajisjeve, eksperti shqyrtues sqaron se në raportin e rivlerësimit nga AK është evidentuar se OE ankues e plotëson kërkesën për pajisje. Po ashtu, edhe në njoftimin mbi vendimin e AK-së nuk ka një arsyetim të tillë për OE ankues, prandaj pretendimi mbi këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK, gjatë vlerësimit të ofertave, nuk ka respektuar nenin 7 dhe 59 të LPP-së si dhe nenin 40 të RRPP-së, dhe si rezultat pretendimet, në tërësi, të OE ankues janë pjesërisht të bazuara.

Përgjigje ne pretendimin e 2: Pretendimi në këtë pikë ka të bëjë me vlefshmërinë e standardit ISO 14001 I cili pretendim është trajtuar edhe ne pretendimin e pare dhe i është dhënë përgjigje. Është vlerësuar se pretendimi është I bazuar prandaj nuk do te shqyrtohet këtu.

Përgjigje në pretendimin e 3: Pretendimi në këtë pikë ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale që sipas FDT-se është kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Në raste të marrjes me qira duhet të ofroj marrëveshje në emër të këtij projekti

Pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate nuk posedon (A test vëllimin) për pajisjen sipas kërkesës 5 te aneksit 7 Kamion apo cistern për pastrimin e rrugëve (me A test vëllimi) – 1 cope .

Eksperti shqyrtues sqaron se me ofertë, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar pajisjen kamion kiper me dy dyer, me regjistrim 01-247-JO, dhe automjet special, i cili posedon pajisje për pastrimin e borës dhe hedhjen e kripës, me regjistrim 01-161-NK.

Pas shqyrtimit të provave të dorëzuara nga OE të rekomanduar për kontratë dhe të ngarkuara në sistemin e E-prokurimit, eksperti shqyrtues konstaton se pajisja e ofruar nuk posedon testin e kërkuar (A test vëllimi), ashtu siç është specifikuar në kërkesat e Dosjes së Tenderit. Si përfundim eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-se dhe se pretendimi është i bazuar.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë nuk janë të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur ne teresi besimin ekspertit shqyrtues sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Andaj PSH, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish, do të ndalet në shqyrtim vetëm në pretendimet përcaktuese lidhur me vendimmarrjen në këto lëndë dhe në përgjigjet në pretendimet ankimore të ekspertit shqyrtues të cilave paneli shqyrtues nuk ja ka fal besimin, siç është përgjigja lidhur me ISO standardet për të cilat eksperti deklaroi se ka bërë verifikimin e vlefshmërisë së certifikatës mirëpo të njëjtat verifikime nuk i ka dëshmuar me dëshmi në raportin e ekspertizës mbi bazën e të cilave PSH do ta kishte me të lehtë për vendimmarrje andaj PSH vendos që t'ia fal besimin vendimit të AK pasi i njëjti është vendosur nga një komisionit vlerësues i cili komision ka konsideruar se OE i rekomanduar plotëson të gjitha kërkesat e parashtruara në DT. Andaj PSH në kuptim të nenit 1 dhe 104 të LPP, duke marrë parasysh të gjitha veprimet e palëve në procedurë të shpjeguara në mënyrë konkrete dhe të hollësishme, vendos ti jep të drejtën AK që të lenë në fuqi vendimin e saj, vendim i një komisioni i cili komision të cilat supozohen të jenë profesionale konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin të plotë të plotë individuale për veprimet e kryera të ofertës”, atëherë në kuptim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos të prolongoj më tepër aktivitetin e prokurimit edhe më tepër dhe pa ndonjë arsye konkrete dhe në ndonjë argument të bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm, atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasurit të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar për marrjen e kontratave edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti

kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si pjesërisht të bazuar, duke rekomanduar vendimi lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ngritja e infrastrukturës së turizmit” me nr. të prokurimit: 615-24-10786-5-2-1, të mbetet në fuqi.

Po ashtu, vlenë të theksohet edhe fakti se neni 72 i LPP, nuk i vë karakter detyrimi AK që të kërkoj sqarime, ngase ka shprehjen "mund". Paneli sqaron se po ashtu se në vështirësi të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventuale, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit, kurse

- Përfundim –

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Paneli sqaron se përveç nenit 1,7,27,28 dhe 59 të Ligjit për Prokurim Publik, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tendere që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë.

Kjo siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe shmang ndikimin në prolongimin e procedurave të prokurimit, me “kërkesa për sqarime të vazhdueshme nga ofertuesit” për dokumentacionet të cilat vazhdimisht i procedojnë për aplikime në ofertat e tyre. Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar. Sepse është evidente dhe e njohur për të gjithë, se në çdo rast të njoftimit për kontratë, secili ofertues do duhej që në fazën paraprake (para ofertimit), ti kundërshtoj të njëjtat apo eventuaisht të parashtrojë pyetje apo të kërkojë sqarime nga AK. Në këtë kontekst edhe sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli, AK por as OE, nuk duhet të thirren në dispozita nënligjore që të kërkojë sqarime shpesh për dokumentacionin e ofertuesve në çdo rast, pasi siç u sqarua si më sipër të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për detyrimet dhe procedurat e aplikimit nëpër tenderë.

Kërkesa e ankuesit për plotësimin e dokumentacionit nuk duhet të shihet si një arsye e vlefshme për të ndërhyrë në procesin e prokurimit në mënyrë të pamjaftueshme të arsyeshme dhe duke ndërhyrë në punën e AK pa ndonjë provë dhe të rrezikoj edhe përmbushjen e nevojave të AK dhe rrezikimin e implementimit të kontratës. Secili e sidomos autoriteti kontraktues duhet të siguron që procedurat e prokurimit të mbeten efikase dhe të përmbushin qëllimin e tyre të sigurimit të kontratave publike në mënyrë të rregullt dhe të drejtë për të gjitha palët e interesuara.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit në mungesë të provave jo kontestuese nuk ofron bazë ligjore për ri-vlerësim eventual të tij dhe nuk është në harmoni me nenin 1 dhe nenin 7 të LPP. Në fakt synimi i këtij aktiviteti të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP, sipas të cilit në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, përfshirë dhe operatorët ekonomik të cilët janë provuar nga qasja në dokumente.

Bazuar në të lartcekurat,

Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PODUJEVËS**
- **OE - Muhamet Muçiqi**
- Arkivës së OSHP-së: